



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Eventiv Sportiv të organizuar nga "Ekipet Sportive në Shkollë".

"Shërbim printimi dhe prodhimi i revistës Team Albania 3 në gjuhën shqipe dhe angleze".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH
2. Rreth shërbimit të kërkuar.....
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.....
4. Metodologjia dhe plani i punës
5. Kualifikimet e nevojshme
6. Procesi i aplikimit
7. Dorëzimi i ofertave
8. Afati i Aplikimit
9. Procesi i Vlerësimit.....
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Shërbime organizimi të ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të promovuar aktivitetet, projektet dhe iniciativat e saj, parashikohet realizimi i shërbimit të printimit të një reviste promovuese “Team Albania 3” në gjuhën shqipe dhe angleze.

Në këtë kuadër, parashikohet printimi i **4,000 kopjeve të revistës**, përkatësisht **2,000 kopje në gjuhën shqipe** dhe **2,000 kopje në gjuhën angleze**, sipas përmbajtjes dhe specifikimeve teknike të miratuara nga autoriteti kontraktor. Revista do të shërbejë si material informues dhe promovues, duke pasqyruar aktivitetet, projektet, arritjet dhe objektivat e organizatës.

Ftohen subjektet e specializuara në fushën e shtypshkrimit, botimeve dhe prodhimit të materialeve të printuara, të interesuara për bashkëpunim, të paraqesin ofertat e tyre në përputhje me specifikimet e kërkuara.

Nëpërmjet kësaj thirrjeje, KOKSH fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertën e tyre ekonomike dhe teknike për realizimin e këtij shërbimi.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmimi pa Tvsh	Vlera	Burimi i Financimit	Kohëzgjatja/ Periudha e përmbajtjes
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>l</i>	<i>2</i>	<i>3=lx2</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
1	Shërbim printimi i revistës në gjuhën shqipe dhe angleze “Team Albania Edicioni 3”	Printimi i 4,000 kopjeve të revistës sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, 2,000 kopje në gjuhën shqipe dhe 2,000 kopje në gjuhën angleze.	Cope	4,000	lekë		Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”.	Sipas afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor 3 muaj

Nëpërmjet këtij bashkëpunimi synohet:

- Sigurimi i printimit cilësor të revistës sipas standardeve profesionale të shtypshkrimit;
- Realizimi i 4,000 kopjeve të revistës në dy gjuhë, shqip dhe anglisht;
- Garantimi i cilësisë së materialeve të printuara, ngjyrave dhe përfundimit final të produktit;
- Respektimi i afateve të dorëzimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor;

4. Metodologjia dhe plani i punës

Për realizimin me cilësi të këtij shërbimi do të përzgjidhet operatori ekonomik që paraqet ofertën më të favorshme ekonomikisht dhe që plotëson kërkesat teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Metodologjia e ndjekur do të përfshijë:

- Përzgjedhjen e operatorit ekonomik përmes një procesi transparent dhe konkurrues;
- Marrjen në dorëzim të materialeve përfundimtare të revistës nga autoriteti kontraktor;



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

- Verifikimin e materialeve për printim sipas specifikimeve teknike të miratuara;
- Realizimin e procesit të printimit për 2,000 kopje në gjuhën shqipe dhe 2,000 kopje në gjuhën angleze;
- Kontrollin e cilësisë gjatë procesit të prodhimit dhe para dorëzimit;
- Paketimin dhe transportimin e revistave në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor;
- Dorëzimin e sasisë së plotë brenda afateve të kontratës;
- Komunikimin dhe koordinimin e vazhdueshëm me autoritetin kontraktor gjatë gjithë procesit të realizimit.

Kohëzgjatja e këtij shërbimi do të jetë në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratë dhe do të përfundojë me dorëzimin e plotë të 4,000 kopjeve të revistës.

Kohëzgjatja e këtij shërbimi do të jetë në përputhje me afatet e zbatimit të projektit “Ekipet Sportive ne Shkolla”, duke synuar përfundimin e përgatitjes dhe botimit të librit brenda periudhës 3 mujore.

5. Kualifikimet e nevojshme

Për të qenë i përshtatshëm për këtë procedurë prokurimi, ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë person juridik i regjistruar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin;
- Të ushtrojë aktivitet në fushën e shtypshkrimit, botimeve ose prodhimit të materialeve të printuara;
- Të paraqesë ofertën në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor;
- Të disponojë kapacitetet teknike dhe profesionale për realizimin e printimit sipas specifikimeve të kërkuara;
- Të ketë eksperiencë në realizimin e shërbimeve të ngjashme të printimit ose botimeve;
- Të ketë kapacitet për realizimin dhe dorëzimin e sasisë së kërkuar brenda afateve të përcaktuara;
- Të sigurojë komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me autoritetin kontraktor gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte dhe person kontakti.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

6. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

7. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 17.03.2026 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

8. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Çmimi - Vlerësohet oferta më e favorshme ekonomikisht, bazuar në çmim	70%
Cilësia dhe kapaciteti – Vlerësohen cilësia e printimit, materialet e përdorura, kapaciteti teknik i operatorit ekonomik, përvoja në realizimin e shërbimeve të ngjashme dhe aftësia për të përmbushur afatet e dorëzimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.	30%

9. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.